



Pranuar / Dorezuar Prijmjenno/Prifilato Received/Deliverty	06-05-2022	2	vit god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	SIPIVESHICK	2658/2022	1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.315/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.315/2022 të datës 30.03.2022 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit/ Administratës Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar ankesa A. nr.315/2022 e datës 30.03.2022 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_**

**A r s y e t i m**

Ankuesja \_\_\_\_\_ e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitën Zyrtar i mbledhjes së detyrueshme sipas Akt emërimit të datës 28.10.2019, me datë 30.03.2022, ka parashtruar ankesë përmes e-mailit me numër protokoll 1703/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore lidhur me transferimin në Departamentin e Mbledhjes së Borgjeve i cili Departament do ta ushtroj veprimtarin në Drejtorin e Përgjithshme Prishtinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 05.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Administrata

Tatimore Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 15.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2161/2022, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës faqe 1/16.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.315/2022 të datës 30.03.2022 përmes e-mailit me numër protokolli 1703 parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 21.02.2022; E-mail zyrtar i datës 12.10.2021-kërkesë për transfer; E-mail zyrtar i datës 22.10.2022; E-mail zyrtar i datës 12.10.2021; E-mail zyrtar i datës 09.12.2021; E-mail zyrtar i datës 12.08.2021; Dokument mbi Strukturën Organizative dhe Funksionimin e Departamentit të Mbledhjes së Borgjeve i datës 08.11.2019; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 15.04.2022 me numër protokolli 2161/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimit të datës 28.10.2019; E-mail zyrtar i datës 21.02.2022; Përcaktimi i numrit të punësuarve në këtë funksion të mbledhjes së borxheve dhe çështjet tjera; E-mail zyrtar i datës 15.04.2022 njoftim për takim; E-mail zyrtar i datës 27.08.2019; E-mail zyrtar i datës 15.04.2022; E-mail zyrtar datës 08.11.2019; Organogrami-Struktura e Përgjithshme Organizative e Funksionit të Mbledhjes së Borgjeve dhe Shkresë njoftuese për reformën në funksionimin e mbledhjes së borgjeve e datës 16.11.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankueses

**SEPSE:**

Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 28.10.2019 është e punësuar në pozitën Zyrtare e Mbledhjes së Detyrueshme në Drejtorinë Rajonale të Gjakovës në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës.

Bazuar në rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Administrata Tatimore e Kosovës duke u bazuar në faktin se vështirësive të mbledhjes së borgjeve në tetor të vitit 2019 reformuar strukturën dhe funksionimin e Departamentit të Mbledhjes së Borgjeve, ku janë paraparë të gjithë zyrtarët me përjashtim nga një zyrtar nëpër Drejtorinë Rajonale, do të angazhohen në Departamentin për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve në Prishtinë. Në bazë të këtij dokumenti është përcaktuar që Divizioni i Burimeve Njerëzore të përkujdeset që lëvizjet e tilla të bëhen në harmoni me nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, që për të gjithë zyrtarët e mbledhjes së detyrueshme të Drejtorive Rajonale të bëhet lëvizja për në Prishtinë dhe të njëjtit të kompensohen për shpenzimet e udhëtimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës, nuk ka gjetur ndonjë dokument që Drejtorët e Drejtorive Rajonale të kenë kundërshtuar këtë strukturë duke pasur parasysh edhe transferimin e zyrtarëve, andaj në shkurt të vitit 2020 ka filluar transferimi i zyrtarëve në Departamentin për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve në Prishtinë.

Në kohën kur është bërë transferimi i ankueses, shkurt 2020 ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloja përkatëse për

Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse në këtë periudhë Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka qenë i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenit 28 paragrafi 2 dhe 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 , është përcaktuar që: *"2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jodisiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë. 3. Ricaktimi mund të bëhet përmes: 3.1. lëvizjes paralele në një zyrë tjetër në kuadër të organizatës së njëjtë ose në organizatë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, brenda administratës qendrore ose komunale; 3.2. rotacionit në një zyrë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, por me detyra të tjera"*, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se nuk ka asnjë provë që ankuesja të ketë kundërshtuar këtë transferim në kohën e transferimit edhe pse ka pasur mundësi duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil mund ta refuzojë transferimin e përhershëm në qoftë se ai e konsideron se vendi tjetër i punës i ofruar është i papërshtatshëm, refuzimi duhet të arsyetohet"* , po ashtu nuk ka asnjë dëshmi që ankuesja këtë ta këtë bërë çoftë edhe nëpërmjet ndonjë ankese.

Lidhur e pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon duhet të kthehet në vendin e saj të punës para se të transferohet në pajtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë konkretisht nenin 52, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se dispozitat transitore të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më saktësisht neni 83 nuk ka paraparë asnjë dispozitë që ky ligj lidhur me procedurat e transferimit të nëpunësve civil nuk ka fuqi prapavepruese përveç nëse një gjë e tillë është parashikuar me ligj, kështu ky ligj për masa disiplinore ka paraparë fuqi prapavepruese siç parashihet me paragrafin 15 të nenit 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Masat disiplinore, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë edhe sipas këtij ligji"*. Po ashtu sa i përket çështjes së udhëtimit dhe faktit që ankuesja gjatë ditës bënë më shumë e 200 KM rrugë nga Juniku për në Prishtinë dhe anasjelltas, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ky transferim ka ardhur si rezultat i nevojës për Administratën Tatimore të Kosovës bazuar në reformë strukturale të këtij institucioni, dhe se sipas informacionit zyrtarë nga ATK-ja për këta zyrtarë të transferuar, në këtë rast edhe për ankuesen nga institucioni është i siguruar edhe udhëtimi i tyre bëhet përmes veturave zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës, pasi që ashtu është përcaktuar edhe në dokumentin mbi bazë e të cilit është bërë struktura organizative dhe funksionimin e Departamentit të Mbledhjes së Borgjeve, andaj bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.315/2022, datë 06.05.2022

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Ankueses
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së;